



This project is funded
by the European Union



CLEAN WATER PROJECT

PROJEKTI: UJË I PASTËR GJAKOVË – KUKËS

implementohet nga:



NË PARTNERITET ME:





**This project is funded
by the European Union**

Hyrje

Komunitetet Lokale/Qyetarët përfaqësojnë përfituesit më të mëdhenj të projektit “Ujë i Pastër Gjakovë – Kukës”. Përfitimi i tyre vjen nga përmirësimi i shërbimeve, shëndeti publik, mjedisi më i pastër dhe cilësia e përgjithshme e përmirësuar e jetës. Ata gjithashtu do të jenë në shënjestër të fushatave për të siguruar që ndotja në të ardhmen të mos ndodhë. Nga zbatimi i veprimit të propozuar përfitojnë edhe komunat e tjera, jashtë territorit të drejtpërdrejtë të Gjakovës/Djakovica dhe Kukësi. Investimet në Llukac do të pastrojnë ujin e lumit, duke e bërë atë shumë më të pastër në daljet nga territori komunal. Në mënyrë të ngjashme, impianti i trajtimit të ujërave të zeza në Kukës, do të mundësojë rrjedhjen e ujit të pastër në liqenin e Fierzës, i cili aktualisht rrjedh i patrajtuar. Edhe ndotja që këta lumenj dhe përrenj sjellin në bregdetin e detit do të reduktohet pasi të kryhen investimet.

Grupet e synuara dhe përfituesit përfundimtarë

Komuna e Gjakovës dhe pushteti lokal i Kukësit kanë treguar përkushtimin e tyre për Ujë të Pastër në territoret e tyre, përmes projekteve investuese të deritanishme, dhe përmes investimeve të planifikuara si pjesë e Veprimit të propozuar. Të dy OJQ-të kanë kapacitete të kufizuara, por tregojnë gatishmëri të lartë për të bërë politikat e nevojshme dhe për të praktikuar përmirësimet në territoret e tyre përkatëse. Autoritetet lokale në rajonin BNK do të jenë përfituesi përfundimtar dhe grupi i synuar për Veprimin e propozuar. Ndërkohë që nga njëra anë do të ngrihen kapacitetet e tyre, do të përmirësohet cilësia e politikave dhe proceset që çojnë drejt këtyre politikave, përfitimi më i madh për autoritetet vendore do të vijë në drejtim të përmirësimit të infrastrukturës dhe përmirësimit të shërbimeve për shoqëritë e shërbimeve publike në pronësi të tyre. Bashkëaplikantë në këtë aksion janë edhe të dy pushtetet vendore, duke dhënë një kontribut të rëndësishëm si në realizimin e aktivitetit ashtu edhe në bashkëfinancimin e aktiviteteve.

Kompanitë e shërbimeve publike Radoniqi në Gjakovë/Djakovica dhe Kompania Ujesjelles Kanalizime SH.A në Kukës, janë grupi i dytë i përfituesve dhe grupet e synuara të veprimit të propozuar. Shërbimet e tyre do të zgjerohen për të përfshirë përqindje më të madhe të popullsisë dhe territorit, do të rriten kapacitetet e tyre njerëzore dhe do të mbështeten për të përmirësuar sistemet e tyre të menaxhimit. Pjesa më e madhe e investimeve në infrastrukturë dhe pajisje do të jetë në dobi të dy kompanive rajonale të ujësjellësit. Gjithashtu, komunikimi dhe kontakti aktiv që synon ndërgjegjësimin e qytetarëve dhe bizneseve për çështjet që lidhen me ujin, do të ndikojë edhe në perceptimin e qytetarëve ndaj fushatës së shërbimeve komunale dhe sigurimin e pajtueshmërisë së tyre me sistemet e ujërave të zeza dhe të kanalizimeve të kërkuara për subjektet industriale. Duke qenë se bizneset përfaqësojnë një burim të madh të ndotjes së rrezikshme (kimike) të ujërave, aktivitetet e ndërgjegjësimit do të përfshijnë një kanal të veçantë për përfshirjen e NVM-ve.



**This project is funded
by the European Union**

OSHC-të lokale, gjithashtu përfaqësojnë një audiencë kyçe të synuar dhe përfitues përfundimtar. OShC-të lokale përfaqësojnë organizata të vogla dhe zakonisht me bazë anëtarët, të cilat rrallë menaxhojnë zhvillimin e ekspertizës dhe infrastrukturës sektoriale. Megjithatë, ka disa organizata dhe grupe mjedisore në të dy anët e kufirit, të cilat kanë mbrojtur në mënyrë aktive çështjet mjedisore. Llojet e tjera të OShC-ve që lidhen me Veprimin përfshijnë organizatat bazë (d.m.th. klubet e peshkimit dhe gjuetisë), shoqatat e fermerëve, OShC-të e demokracisë dhe qeverisjes dhe organizatat rinore. Këto organizata do të përfitojnë drejtpërdrejt nga aktivitetet e zhvillimit të kapaciteteve dhe do të marrin pjesë në proceset lokale për formulimin dhe monitorimin e politikave. Monitorimi i cilësisë së ujit do t'u besohet gjithashtu OShC-ve lokale, duke rritur kështu rolin dhe funksionin e tyre përpara votuesve të tyre.

Detajet e aktivitetit të propozuar

Më 15 Qershor 2022, Shoqata Afariste e Gruas SHE-ERA në bashkëpunim të ngushtë me Qendrën Shqiptare për Kërkime Ekonomike (ACER), Komunën e Gjakovës dhe Komunën e Kukësit do të organizojnë Diskutim Publik me qytetarët për diskutuar benefitet e projektit 'Ujë i Pastër Gjakovë – Kukës' lidhur me "Investimet në rehabilitimin e kolektorit të ujërave të zeza në Bashkinë Kukës" dhe ndërtimin e një ekosistemi të qëndrueshëm për një jetë më të mirë në Bashkinë Kukës.



This project is funded
by the European Union

DËGJESË PUBLIKE

AGJENDA

“Projekti dhe ecuria e implementimit të kanalit kryesor të Ujërave,
situata e Ujësjes dhe problematika për zgjidhje – Bashkia Kukës”

Organizuar nga

*Shoqata Afariste e Gruas SHE-ERA,
Albanian Center for Economic Research ACER,
Bashkia Kukës dhe Komuna e Gjakovës*

Data: 17 Qershor 2022

Ora: 11.:00

Vendi: Salla e Amerikan Corner, Kati dyte , Palati Kultures , Kukës

Sheshi "Skënderbej", Kukës Lagja 5, 8501

10:00 – 10:30	Regjistrimi i pjesëmarrësve
10:30 – 11:00	Fjalimet hyrëse
	1. Safet GJICI, Kryetar i Bashkisë Kukës 2. Mirlinda KUSARI - PURRINI, Shoqata Afariste e Gruas SHE-ERA 3. Anilda Biba Kryetare e Keshillit Bashkiak
11:00 - 11.30	Andrit SHEHU, Arkitekt, Drejtor i Urbanistikes Hasije GJANA, Inxhinier Hidroteknik , Drejtor i Ndermarrjes Ujesjellesit Instrumentat e Degjeses Publike- Sekretariati Keshillit Bashkiak Kukës
11:30 – 11:45	Kujdesi TODAJ, DENOLT sh.p.k.
11:45 – 12:30	Diskutime interaktive me qytetar dhe konkluzione ¹
12:30	Mbyllja e diskutimit publik

¹ Konkluzionet e diskutimeve do të përfshihen në dokumentin përfundimtar.